



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.204/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Afjete Sada Glllogjani dhe Kymete Kicaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa Anr.204/2019 e datës 03.10.2019 e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, dhe subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, i shqiptohet gjobë në lartësi prej 2,700.00 (dy mijë e shtatëqind) euro, për shkak të përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore, të cilën shumë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 03.10.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se me datën 03.10.2019, rreth orës 01:30, në tubimin zgjedhor të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), në Gjakovë, janë parë fëmijë duke mbajtur në trup materiale promovuese të fushatës, në mesin e të cilëve ishin dy fëmijë të cilët mbanin bluza me materiale promovuese të kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik LDK, Zef Morina, veprim ky i cili sipas paraqitësit të ankesës bie në kundërshtim me Rregullën Zgjedhore Nr.20/2019 për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet”, përkatësisht nenin 5 par. 3 pikën b) të kësaj rregulle zgjedhore. Paraqitësi i ankesës, si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur disa fotografi të printuara në cilësi të provave materiale.

Më datë 03.10.2019, PZAP-i, njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për ankesën e paraqitur ndaj tij, duke i dhënë afat për përgjigje, deri më datë 04.10.2019 në ora 12:00, mirëpo deri në këtë kohë, PZAP-i, nuk mori ndonjë përgjigje nga ana e subjektit politik në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e bashkangjitura si provë nga paraqitësi i ankesës shihet qartë se në tubimin zgjedhor të subjektit politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK), janë përdorë fëmijët të mitur, të cilët ndër të tjera, kanë qenë të pajisur me materiale promovuese të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), veprime këto të sanksionuara sipas dispozitës ligjore të Rregullës Zgjedhore Nr.20/2019 të datës 26.09.2019, për Ndryshimin

dhe Plotësimin e Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, respektivisht nenin 2 par.3, pika b), c) dhe d) të kësaj Rregulle, e cila dispozitë ndër të tjera përcakton se: “ ... asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të përfshinë personat të cilët nuk i kanë mbushur 15 vjet në veprimet e mëposhtme: ...; b) bartin pankarta dhe materiale tjera promovuese gjatë aktivitetit të fushatës zgjedhore; c) të jenë pjesë aktive e materialeve promovuese politike për të shmangur etiketimin e mundshëm, ngacmimin dhe çfarëdo ndikimi tjetër negativ të tyre; d) të jenë pjesë aktive e materialeve promovuese politike në fushatë zgjedhore me qëllim për të marrë vota emocionale të elektoratit”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik LDK, është shkelur neni 2 par.3 pika b), c) dhe d) i Rregullës Zgjedhore Nr.20/2019 të datës 26.09.2019, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, pasi që fëmijët në tubimin e fushatës zgjedhore të këtij subjekti politik, në veshjet e tyre kanë bartur material promovues për subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se është njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe përkundër këtij fakti nga ana e këtij subjekti gjatë aktivitetit të fushatës zgjedhore janë përdorur personat e mitur dhe atë duke mbartur në veshjet e tyre material promovues të subjektit politik LDK, gjë e cila është në kundërshtim me dispozitat e lartëcekura ligjore.

Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur në ankesë, mirëpo subjekti politik, nuk ofroi ndonjë përgjigje lidhur me pretendimet ankimore të paraqitësit të ankesës, veprime këto të cilat kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.204/2019 më datë 05.10.2019



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.